

PËRSHËNDETJA E Z. BESNIK DERVISHI
NË “KONFERENCËN III KOMBËTARE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT –
KOORDINATORI DHE SHOQËRIA CIVILE”

Të nderuar pjesëmarrës, përfaqësues të Autoriteteve Publike dhe koordinatorë, përfaqësues të shoqërisë civile, medias, etj.

Kemi krijuar tashmë një traditë të mirë në organizimin e takimit kombëtar të përvitshëm për të Drejtën e Informimit.

Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka krijuar një standard të prekshëm çdo ditë nga qytetarët.

Në të njëjtën kohë, Zyra Komisionerit ka punuar fort dhe natyrisht, ndjehemi mirë që kjo vlerësohet nga institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare.

Vlerësoj mbështetjen e Kuvendit, Këshillin e Ministrave për mjediset e reja dhe e reja e fundit, partnerin e ri të Zyrës së Komisionerit, zyrën e OSBE në Tiranë.

Në këta 30 muaj të zbatimit të ligjit ka arritje për të cilat duhet të ndihemi mirë, më kryesorja prej të cilave, është puna për të ndryshuar mentalitetin dhe kulturën e administratës sonë publike. **“Çdo gjë që është zyrtare nuk është publike, në fakt është e kundërta, çdo gjë që është zyrtare është publike!”**

Shqipëria renditet e 6-ta në botë për kuadrin ligjor për të drejtën e informimit, nga vendi i 85-të që kishte më parë. Ky është pozicionimi më i lartë i arritur ndonjë herë nga vendi ynë.

Qëllimi i këtij ligji është i dyfishtë:

- të garantojë të drejtën e informimit – aksesin në dokumentat zyrtare, si dhe
- llogaridhënien mbi aktivitetin e administratës publike.

Dhe këtu nuk mund të lë pa përmendur dy projekte shumë të rëndësishme të BE ku Zyra e Komisionerit është pjesë:

Suporti Buxhetor i Administratës Publike dhe Projekti i Binjakëzimit Anti-Korrupsion.

Edhe pse jemi në vitin e tretë, nuk mund të pretendohet se kemi bërë gjithçka.

Është shqetësuese situata në disa Autoritete Publike ku konstatohet qartë mungesa e vullnetit për të bërë publik informacion të kategorive të caktuara, por edhe më tepër, urdhërohet nga titullarët më të lartë në mënyrë krejt arbitrare mosdhënia e informacionit që duhet të jetë publik.

Ka ngjarje më të rëndë se të shkelësh kushtetuten dhe ligjin dhe kur kjo bëhet nga zyrtarë të nivelit më të lartë?

Për ata që nuk e dinë ende, ne bëjmë punën tonë, edhe pse jo rrallë të intimiduar.

Ndërkohë, nuk dëshiroj ta quaj intimidim mungesën e mbështetjes për forcimin me kapacitete në burime njerëzore dhe financiare të Zyrës së Komisionerit edhe pse për dy vjet rresht progres-raporti i BE e nënvizon qartë.

Të nderuar koordinatorë,

Ligji jua ngarkon juve detyrat kryesore për zbatim e ligjit “Për të drejtën e informimit”, së bashku me kompetencat, si dhe përgjegjësitë.

Zyra e Komisionerit po bën të pamundurën për të konsoliduar rolin tuaj, pikërisht atë rol që ju jep ligji. Do të propozojmë edhe deri trajtim financiar shtesë.

Por jeni vetë ju që duhet ta ndani në se jeni apo jo koordinatorë, edhe kur vendoseni në pamundësi nga titullari apo kushdo tjetër nëpunës për të ushtruar detyrën që jua jep ligji.

Dhe këtu nuk mund të bëjmë më kompromis. Pra, kuptohet në mungesë të transparencës do të ketë më shumë vendime urdhërimi dhe sanksione edhe pse personalisht jam i prirur të besoj që nuk janë sanksionet që e bëjnë transparencën.

Dua t’ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe t’ju nxis të jeni sa më aktivë me diskutimet, opinionet dhe ndarjen e eksperiencës tuaj.